VENDIM
Nr.147/1, datë 7.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË AKSESIT NË RRJETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e "CEZ shpërndarje" sh.a., për përcaktimin e tarifës së aksesit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa e aksesit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012-2014), do të jetë:

Në TM - 3.2 lekë/kWh.

Në TU - 5.4 lekë/kWh.

2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e "CEZ shpërndarje" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani